




Bujqësia 2025: Prioritet kombëtar në fjalë, por jo në vepra

Alba Tema, Hulumtuese

Evelina Azizaj, Koordinatore Kombëtare

Ministria e Financave ka publikuar së fundmi projekt buxhetin për vitin 2025, me një total prej 822.7 miliardë lekë. Sipas këtij buxheti, sektorët prioritarë janë Shëndetësia dhe Mbrojtja Sociale (80.7 miliardë lekë), Infrastruktura dhe Energjia (74 miliardë lekë), si dhe Arsimi dhe Sporti (62 miliardë lekë). Ndërkohë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural renditet e shtata për nga fondi i alokuar, me rreth 14.6 miliardë lekë.¹ Në krahasim me buxhetin e vitit 2024, ky fond shënon një rritje vetëm 4%. Kjo është një rritje minimale duke marrë parasysh që bujqësia promovohet si një sektor prioritar për zhvillimin e vendit. Në fjalë, bujqësia mbetet prioritet kombëtar, në vepra, një sektor që vazhdon të mbetet i nënvlerësuar.


Figura 1. Shpërndarja e fondeve të projekt buxhetit 2025 sipas ministrive përkatëse (miliardë lekë)



Burimi: Ministria e Financave, 2024. <https://financa.gov.al/buxheti-2/>.

Pjesa më e madhe e buxhetit për bujqësinë, rreth 7.2 miliardë lekë, është alokuar për Zhvillimin Rural përmes mbështetjes së prodhimit bujqësor dhe blegtoral, agroindustrisë dhe marketingut. Nga këto, 4.4 miliardë lekë shkojnë për mbështetje direkte për fermerët, për skemën e naftës falas si dhe për kryerjen e punimeve të mekanizuara në bujqësi dhe skemën e investimeve prioritare në ferma. Gjithashtu, një tjetër prioritet në sektorin e bujqësisë është siguria ushqimore, me një fond prej 2.6 miliardë lekë, si dhe infrastruktura e ujitje dhe kullimit dhe mbrojtja nga përmbytjet me një fond prej 2.9 miliardë lekësh.²

Figura 2. Ndarja e fondeve të projekt buxhetit 2025 të MBZHR sipas zërave përkatës (miliardë lekë)




¹ Ministria e Financave (2024). Buxheti. Për ta aksesuar: <https://financa.gov.al/buxheti-2/>

² Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (2024). Deklaratë për shtyp: Denaj prezanton p/buxhetin 2025: 15 miliardë lekë për bujqësinë dhe zhvillimin rural. Për ta aksesuar: <https://www.bujqesia.gov.al/denaj-prezanton-p-buxhetin-2025-15-miljarde-leke-per-bujqesine-dhe-zhvillimin-rural/>

Burimi: Ministria e Financave, 2024. <https://financa.gov.al/buxheti-2/>.

Sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural mbetet një ndër sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare, duke kontribuar me 18.3% në Produktin e Brendshëm Bruto dhe duke punësuar rreth 32% të popullsisë aktive të vendit.³ Megjithatë, pavarësisht rëndësisë ekonomike dhe sociale të sektorit, ai ka shfaqur tendenca të tkurrjes në vitet e fundit. Rritja vjetore e vlerës së shtuar në PBB ka shënuar një rënie për herë të parë pas shumë vitesh, duke arritur në -0.68% në vitin 2023. Nga ana tjetër, treguesit e punësimit në sektor kanë shfaqur ulje të konsiderueshme, me një rënie prej 8% krahasuar me vitin 2016.⁴

Figura 3. Kontributi i sektorit të bujqësisë, pyjeve dhe peshkimit në PBB, punësim dhe rritja vjetore në vlerën e shtuar (%)



Burimi: Banka Botërore, 2024. <https://databank.eorlbank.org/reports.aspx?source=2&country=ARE>

Konkurrenca mes produkteve vendase dhe atyre të importuara po bëhet gjithnjë e më shqetësuese; bilanci tregtar i eksporteve dhe importeve për produktet agro-ushqimore në vitin 2023 arriti në -80,754 milion lekë.⁵ Kjo pasqyron një problem të madh për sektorin, ndërsa mbështetja buxhetore për bujqësinë dhe zhvillimin rural vazhdon të mbetet e pamjaftueshme, duke qenë një këmbanë alarmi ndër vite. Shqipëria ka një ndër nivelet më të ulëta të mbështetjes për fermerët në Ballkanin Perëndimor.⁶ Të dhënat e fundit tregojnë një tkurrje të dukshme prej 33% në numrin e krerëve të mbarështuara⁷ në vendin tonë gjatë viteve 2018-2023, një shenjë e qartë e krizës që po përjeton ky sektor. Mungesa e fuqisë punëtore për shkak të migrimit të vazhdueshëm nga zonat rurale dhe humbjes së interesit për t'u angazhuar në bujqësi,


3 Banka Botërore (2024). World Development Indicators. Për ta aksesuar: <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?source=2&country=ARE>

4 Banka Botërore (2024). World Development Indicators. Për ta aksesuar: <https://databank.worldbank.org/reports.aspx?source=2&country=ARE>

5 INSTAT (2024). Databaza statistikore. Për ta aksesuar: https://databaza.instat.gov.al:8083/pxweb/sq/DST/START_FT_FTY/NewFTY001/table/tableViewLayout1/

6 OECD (2024), Western Balkans Competitiveness Outlook 2024: Albania, Competitiveness and Private Sector Development, OECD Publishing, Paris, <https://doi.org/10.1787/541ec4e7-en>.

⁷ Këtu përfshihen: gjedhë, lopë, të imta, të leshta, dele, të dhirta



përkeqësohet edhe nga mbështetja e pamjaftueshme financiare dhe teknike për fermat. Ky kombinim faktorësh ka bërë që bujqësia dhe zhvillimi rural të jenë në gjendje të vështirë, duke i mohuar fermerëve mundësinë për të siguruar mirëqenie dhe qëndrueshmëri të burimeve të jetesës.

Pezullimi i fondeve të IPARD II gjatë vitit 2024 përbën një moment kritik për zhvillimin dhe modernizimin e sektorit bujqësor, duke vështirësuar përputhshmërinë me standartet e Bashkimit Evropian. Sipas raportit të fundit të publikuar nga OLAF⁸, janë evidentuar disa parregullsi të rënda gjatë fazës së dhënies së granteve dhe zbatimit të disa projekteve. Nisur nga këto gjetje, Komisioni Evropian e konsideroi si të pajustifikueshëm një pjesë të financimit të Thirrjes së Parë dhe të Dytë për Aplikime IPARD II, që arrin në rreth 33 milionë euro. Gjithashtu OLAF ka rekomanduar pezullimin e financimit të ardhshëm prej rreth 112 milionë euro për Shqipërinë, përmes IPARD III, deri në marrjen e masave të nevojshme për të siguruar mirëmenaxhimin e këtyre fondeve.⁹

Bujqësia, zhvillimi rural dhe peshkimi janë ndër sektorët që priten të transformohen në kuadër të përpjekjeve integruese të vendit në BE. Sipas progres raportit të publikuar nga Komisioni Evropian për *Kapitullin 11: Bujqësia dhe zhvillimi rural*, Shqipëria ka patur progres të kufizuar, ndërkohë që për *Kapitullin 12: Siguria ushqimore, politika veterinarë dhe fitosanitare*, nuk është bërë progres gjatë periudhës raportuese. Përgjithësisht, rekomandimet e raportit janë të njëjta me ato të viteve të kaluara, duke përfshirë përafrimin e plotë të regjistrimit të fermave me *acquis* të BE-së, harmonizimin e sistemit të integruar të administrimit dhe kontrollit (IACS), sistemin e identifikimit të parcelave të tokës (LPIS) si dhe organizimin e tregut të përbashkët (CMO).¹⁰

Në këtë kontekst, është e qartë se sektori kërkon përpjekje dhe investime të konsiderueshme për modernizimin e tij dhe për të përmbushur standartet evropiane. Megjithatë, sfidat e paadresuara të sektorit dhe komuniteteve rurale, veçanërisht të fermerëve të vegjël, mbeten një pengesë e madhe. Në të dyja rastet, proceset integruese evropiane në sektor dhe mirëqenia dhe qëndrueshmëria sociale dhe ekonomike e fermave dhe komuniteteve rurale, kërkojnë mbështetje të konsiderueshme financiare. Nëse bujqësia nuk kthehet në prioritet të qeverisë, shoqëruar me mbështetje financiare që rritet çdo vit, ekziston rreziku që sektori të humbasë potencialin e tij të plotë në kontributin ekonomik të vendit, dhe në qëndrueshmërinë e jetës komunitare në zonat rurale.

Në përfundim, sektori i bujqësisë dhe zhvillimit rural është në një moment të vështirë, përballë mungesës së mbështetjes financiare, rritjes së konkurrencës nga produktet e importuara dhe sfidave ende të paadresuara ndër vite. Projektbuxheti i vitit 2025 e rendit atë ndër sektorët më pak prioritarë, dhe në mungesë të mbështetjes nga fondet e IPARD dhe normat e ulëta të kreditimit nga institucionet financiare, do të thellojnë krizën për burime financiare në sektor, duke vënë në rrezik zhvillimin e tij të qëndrueshëm.

Për këtë arsye, është urgjente që qeveria të përfshijë bujqësinë dhe zhvillimin rural në agjendën e saj si një prioritet të vërtetë. Kjo do të thotë rritje të mbështetjes buxhetore duke i kthyer sektorit një pjesë të konsiderueshme të kontributit në ekonomi, të paktën 50% nga ky kontribut. Gjithashtu, është e rëndësishme të krijohet një sistem mbështetjeje më i afërt me


⁸ European Anti-Fraud Office

⁹ OLAF (2024). The OLAF report 2023. Për ta aksesuar: https://ec.europa.eu/olaf-report/2023/investigative-activities/protecting-eu-funds/international-investigations_en.html

¹⁰ Komisioni Evropian, (2024). Raporti për Shqipërinë 2024. Për ta aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2024_en

Komisioni Evropian, (2023). Raporti për Shqipërinë 2023. Për ta aksesuar: https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/albania-report-2023_en





nevojat reale të fermerëve dhe aktorëve të tjerë të zonave rurale, duke monitoruar dhe rivlerësuar masat mbështetëse, për t'i përshtatur ato me kërkesat dhe sfidat me të cilat ata përballen në terren.

Në një kohë kur integrimi në Bashkimin Evropian kërkon që Shqipëria të përmbushë standarde të larta për zhvillim dhe modernizim, njohja e rëndësisë së bujqësisë dhe mbështetja e qëndrueshme për fermerët është një hap i domosdoshëm për të siguruar zhvillim të qëndrueshëm dhe rritje të produktivitetit. Vetëm duke e prioritetizuar sektorin bujqësor mund të realizohet një transformim i tij dhe të mundësohet një e ardhme më e mirë për fermerët dhe komunitetet rurale të Shqipërisë.

